



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11, 12.1, 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neneve 14, 15.1, 15 parag. 2.4 dhe 34 parag. 2.4 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 87.1 të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës, nr.01/146-11 të datës 29 prill 2010, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 dhjetor 2020, mori,

### **VENDIM PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2021**

#### **Neni 1**

Miratohet Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2021

#### **Neni 2**

Kuvendi i Komunës përveç pikave të parapara me këtë plan shqyrton edhe çështje tjera sipas nevojës, mban edhe mbledhje tjera varësisht nevojave dhe kërkesave të paraqitura për shqyrtim dhe miratim.

#### **Neni 3**

Plani i punës, në formë tabelore, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Nr. 01-060/01-0079687/20**  
**Podujevë,**  
**30 dhjetor 2020**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Fatmir Gashi**





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

### **PLANI I PUNËS** **SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2021**

**Dhjetor 2020**

## **Parathënie**

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët, dhe funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

Kuvendi i Komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregullores së punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe rëmërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- Përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Kuvendi i Komunës siguron kushte të punës për mbajtje të seancave të Kuvendit të Komunës, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i Komunës, kryen edhe aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësi të saj, përfshirë edhe funksione tjera, detyra dhe përgjegjësi të pa deleguara si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e Komunës;
- Miratimin e akteve /dokumenteve të planifikimit hapësinorë, Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), Hartës Zonale (HZK), dhe Planeve Rregulluese të Hollësishme (PRRH), plotësim ndryshimin/revizimin e tyre, si dokumenteve tjera nga fusha e planifikimit hapësinor; dhe

- Themelimin e ndërmarrjeve publike të Komunës.

Për marrjen e vendimeve Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komitetit të caktuar të Kuvendit apo Kryetarit të Komunës dhe këtë delegim mund ta tërheqë në çdo kohë.

Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës është dokument i mbështetur në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet tjera nënligjore. Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, Statuti dhe aktet tjera nënligjore.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2021, ku Kuvendi i Komunës së Podujevës planifikon t'i mbaj 11 (njëmbëdhjetë) seanca të rregullta, 6 (gjashtë) prej të cilave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në interes të Komunës dhe të qytetarëve të Podujevës, e të cilat janë të proceduara sipas akteve në fuqi:

- Cakton datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit sipas rregullores së punës së Kuvendit;
- Themelon Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete sipas ligjit;
- Funksionalizon komitetet e formuara këshillëdhënëse dhe planifikon raportimin e këtyre komiteteve para Kuvendit së paku një herë në vit.
- Planifikon shqyrtimin e raporteve e rregullta të punës së Kryetarit të Komunës sipas ligjit;
- Inkorporon planin e tubimeve me qytetarë të Kryetarit të Komunës;
- Miraton buxhetin, planet investuese, planin vjetor të prokurimit, planin vjetor të punës së auditorit të brendshëm, planet rregullative etj.
- Miraton çështje tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas Statutit apo Rregullores së punës;
- Nxjerr rregullore të reja dhe bënë harmonizimin e rregulloreve ekzistuese me ligjet në fuqi;
- Inkorporon planin e Kryetarit për festa shtetërore e kombëtare.
- Mbikëqyrë, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit;

### **Përfundim**

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës, do të ndihmojë dhe lehtësojë punimet e mbledhjeve të Kuvendit, duke iu ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2021 që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve.

Me planin e punës janë paraparë 11 seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca tjera përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme, siç parashihet me LVL dhe Statutin e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit mbanë takime mujore me shefat e grupeve të këshilltarëve të Kuvendit, për të bashkërenditur punën e komiteteve obligative dhe funksionale dhe punën e Kuvendit të Komunës.

Për përmbushjen e Programit të punës, Ekzekutivi ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të Kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe agjendës sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit të të gjitha aktiviteteve, sipas dinamikës të përcaktuar me këtë program, do të përkujdesen Kryetari, Kryesuesi i Kuvendit.

Realizimi i Programit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Ekzekutivin e Komunës, e cila duhet t'i përmbahet planit të Kuvendit për vitin 2020.

Plani i punës së Kuvendit sipas dinamikës mujore përfshinë: emërtimin e aktit, propozuesin, afatin e dërgimit nga propozuesi, afatet e shqyrtimeve nga komitetet funksionale përgjegjëse për shqyrtim.

Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2021 do të plotësohet edhe me:

- Miratimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar.
- Propozime për debate dhe propozime përmbajtjesore,
- Propozime për raportime dhe informata,
- Peticione,
- Pyetje të anëtarëve të Kuvendit.

**Shtojcë:** *Plani i punës sipas muajve*

**PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2021**

**JANAR 2021**

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak
		Dytësor	Parësor		
1.	Raporti i punës së Kuvendit për vitin 2020				
2.	Informatë e përgjithshme e Drejtorisë së Administratës				
3.	Informatë e përgjithshme e Drejtorisë së Arsimit				
4.	Informatë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (me theks të veçantë Pandemia Covid-19)				
5.	Të ndryshme				

**SHKURT 2021**

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak
		Dytësor	Parësor		
1.	Raporti vjetor mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore në vitin 2020				
2.	Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSBB për vitin 2021				
3.	Raporti vjetor i Ndërmarrjeve Publike				
4.	Informatë e detajuar e punës së Prokurimit për vitin 2020				
5.	Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2020				
6.	Të ndryshme				

**MARS 2021**

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak
		Dytësor	Parësor		
1.	Raporti financiar për vitin 2020				
2.	Raporti i punës së Kryetarit të Komunës				
3.	Raporti i KKSBB-së për vitin 2020				
4.	Informatë e përgjithshme nga Drejtoria e Inspeksionit				
5.	Informatë e përgjithshme e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë				
6.	Informatë për trajtimin e qeneve endacak				
7.	Informatë e përgjithshme nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit				
8.	Të ndryshme				

**PRILL 2021**

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak
		Dytësor	Parësor		
1.	Raporti financiar tre mujor, janar-mars për vitin 2021				
2.	Informatë e përgjithshme e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit				
3.	Informatë mbi Strategjinë e turizmit në Komunën e Podujevës				
4.	Të ndryshme				

**MAJ 2021**

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak
		Dytësor	Parësor		
1.	Raporti i auditorit të brendshëm				
2.	Informatë lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Podujevës				
3.	Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës				
4.	Informatë për ndarjen e bursave për studentë				
5.	Të ndryshme				

**QERSHOR 2021**

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak
		Dytësor	Parësor		
1.	Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2022-2024				
2.	Rishikimi i buxhetit për vitin 2021				
3.	Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020				
4.	Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria e Administratës				
5.	Të ndryshme				

**KORRIK 2021**

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak
		Dytësor	Parësor		
1.	Raporti financiar gjashtë mujor, janar-qershor 2021				
2.	Informatë për vitin shkollor 2020 - 2021				
3.	Informatë e përgjithshme e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit				
4.	Të ndryshme				

**GUSHT 2021**

Nr.	OBJEKTIVAT
1.	<b>Pushim</b> përveç ndonjë mbledhje për ndonjë çështje - rrethanë urgjente

**SHTATOR 2021**

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak
		Dytësor	Parësor		
1.	Miratimi i projektbuxhetit për vitin 2022 dhe planifikimet buxhetore për vitet 2023/2024				
2.	Informatë për përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2021/2022				
3.	Miratimi i Rregullores për tatimin në pronë				
4.	Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ( me theks të veçantë korrje-shirjet)				
5.	Të ndryshme				

**TETOR 2021**

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak
		Dytësor	Parësor		
1.	Raporti financiar nëntë mujor periudha janar-shtator 2021				
2.	Ri-alokimi dhe transferi i buxhetit për vitin 2021				
3.	Informatë lidhur me mbrojtjen e mjedisit				
4.	Informatë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit				
5.	Të ndryshme				

**NËNTOR 2021**

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak
		Dytësor	Parësor		
1.	Ngritja e grupit punues për hartimin e planit të punës për vitin 2022				
2.	Informatë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale				
3.	Të ndryshme				

**DHJETOR 2021**

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak
		Dytësor	Parësor		
1.	Plani i punës i Kuvendit të komunës për vitin 2022				
2.	Të ndryshme				

Podujevë,  
30 dhjetor 2020

Kryesuesi i Kuvendit  
Fatmir Gashi

